



## Departamenti i Prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 03.02.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "SFISHTA AUTO HOME" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të QKMF-se dhe QMU-se-ritender", me Nr. të Prok: 616 22 14303 211 dhe numër të brendshëm: 616 22 209 211 nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërishte e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "SFISHTA AUTO HOME" SH.P.K të dt. 03.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të QKMF-se dhe QMU-se-ritender" " 616 22 14303 211 dhe numër të brendshëm: 616 22 209 211 kundër Njoftimit mbi vendimin e AK –së, të datës 30.01.2023 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te kthej në rivlerësim aktivitetin e prokurimit per* "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të QKMF-se dhe QMU-se-ritender" " 616 22 14303 211 dhe numër të brendshëm: 616 22 209 211
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatorët Ekonomik "SFISHTA AUTO HOME" SH.P.K me datë 03.02.2022 ka parashtruar kërkesa për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të QKMF-se dhe QMU-se-ritender" " 616 22 14303 211 dhe numër të brendshëm: 616 22 209 211

Autoriteti Kontraktues, me datë 03.02.2023, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë.

- Pretendimi ankimor i OE Sfishta auto home SH.P.K se si komisioni për ekzaminim nuk e ka vërejte një detal qe shifet shume kjarte, se si është e mundur qe një OE te oferton pa Sigurim te tenderit, pa deklaratën nen betim neni 6.4 te FDT-se, pa dokumentat e nenit 7.1 dhe 7.2 kjo i bie qe ky tender i OE Mert Shpk eshte fiktiv, vetëm e vetëm për te bere numër ne procedure dhe asgjë tjetër dhe nga shënimet qe vërehen dyshohet qe tenderin e këtij OE e ka plotësuar OE i rekomanduar për kontrate.

**Ky pretendin nuk qëndron për faktin qe ju si duket nuk keni vërejtur se për te njëjtat arsye OE iu ka dërguar letra standarde për eliminim dhe po ashtu sa i përket asaj se OE ka dërguar oferte vetëm sa për ta plotësuar numrin , edhe kjo nuk qëndron se nuk ka nevojë te plotësohet kurrfarë numri për faktin ne një procedure te prokurimit është e lejuar te vazhdohet edhe vetëm me një oferte.**

Pretendimi tjetër ankimor se OE i rekomanduar për kontrate ne pozicioni nr. 42 te para masës pjesa B ka dhënë çmimin 0.00, ky pretendim qëndron, andaj AK bazuar ne LPP dhe ne Rregulloren për Prokurim Publik nenin: 40.16 qe thotë se: **Në rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull/pozicion të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet që të dërgohet një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro.**

**a. Nëse Operatori Ekonomik pranon se ai artikull i veçantë nuk është i përfshirë në tender, tenderi duhet të refuzohet.**

**b. Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme,**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Prishtina: datë, 03.02.2023

Nexhmi Mekolli



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

Nexhmi Mekolli